



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.11.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratim i kalendarit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.
2. Shqyrtim i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të konferencës së shteteve anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët, (STCW) 1978”.

Të ftuar:

Artan Shkreli - Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Eltar Deda - Drejtor i Përgjithshëm i Infrastrukturës në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Bledar Karoli - Përgjegjës sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Luan Harusha, Paulin Sterkaj, Artemis Dralo, Luan Duzha, Antoneta Dhima, Xhemal Qefalia, Lefter Maliqi, Edmond Rrushi, Ylli Shehu, Myslym Murrizi, Elena Xhina.

Mungojnë:

Arben Elezi, Anduel Xhindi, Alban Zeneli.

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita, kolegë!

Hapim mbledhjen e Komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtarë për ditën e sotme. Më lejoni t'i uroj mirëseardhjen një kolegu të ri në komisionin tonë, zotit Edmond Stojku. Mirë se erdhët dhe punë të mbarë së bashku!

Faleminderit!

Në rendin e ditës së sotme kemi programuar miratimin e kalendarit të veçantë “Për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020””. Sikurse e dini, javën e shkuar u mbledh Konferenca e Kryetarëve, e cila vendosi për kalendarin e veçantë dhe të përgjithshëm të mbledhjeve të komisioneve që lidhen me shqyrtimin në parim dhe mandej nen për nen dhe në tërësi të buxhetit të institucioneve që janë pjesë e fushës së përgjegjësisë të secilit prej komisioneve parlamentare.

Kalendari i veçantë na imponon t'i bëjmë të gjitha mbledhjet brenda datave të përcaktuara nga Konferenca e Kryetarëve dhe mandej të miratuara edhe nga Kuvendi i Shqipërisë në seancën e ditës së hënë. Kështu që, dua t'ju njoftoj që javën e ardhshme ne do të fillojmë me seancat dëgjimore për buxhetin. Do të jenë të gjitha diskutime në parim për buxhetin e institucioneve që janë në fushën e përgjegjësisë së këtij komisioni, për t'i përfunduar ato brenda datës 2 dhjetor, kur ne detyrohemi t'i dorëzojmë Komisionit për Ekonominë dhe Financat raportin përkatës.

Pasi të zhvillohet edhe seanca për diskutimin në parim në Kuvendin e Shqipërisë, ne do të fillojmë zbatimin e një tjetër kalendari që ka të bëjë me diskutimin nen për nen.

Këshilltarët e komisionit ju kanë vënë në dijeni për një pjesë të kalendarit, por meqenëse e kemi përmbyllur të gjithë kalendarin, mund t'ju vëmë atë në dispozicion në mënyrë që çdokush nga deputetët të jetë i njohur paraprakisht me detyrimet që imponon ky kalendar.

Në komision tonë ka disa anëtarë që janë pjesë e asambleve së ndryshme parlamentare, siç është Asambleja Parlamentare e NATO-s apo Asambleja Parlamentare e OSBE-së, të cilëve ju kanë ardhur disa ftesa për të marrë pjesë në takime ndërkombëtare, megjithatë ne jemi mundur në mënyrën më maksimale të mundshme t'i respektojmë ato data duke mos penguar asnjë prej kolegëve që të shkojë edhe në këto aktivitete.

Mendoj që nuk ka vërejtje për këtë pikë, kështu që mund ta kalojmë.

Pika e dytë e rendit të ditës është shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të konferencës së shteteve anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët”.

Do të donim të kuptonim nga fjala e zëvendësministrit, zoti Artan Shkreli, i cili është prezent së bashku me zotin Bledar Karoli dhe ish-kolegun tonë Eltar Deda, drejtor i përgjithshëm i infrastrukturës në ministrinë përkatëse, përmbajtjen e kësaj konvente, nevojën që ka Shqipëria për të aderuar në instrumente të tillë ndërkombëtare dhe lidhjen e posaçme që kjo konventë ka me sigurinë, atë që ne ndjekim në komisionin tonë.

Relator i këtij projektligji është caktuar zoti Vorpsi.

Pa humbur kohë, fjalën e ka zoti Shkreli për të bërë një prezantim të përmbledhur brenda limiteve që lidhen me këndvështrimin tonë si komision për këtë konventë.

Faleminderit, zoti Shkreli!

Artan Shkreli – Mirëdita!

Faleminderit për mundësinë që na jepni për të paraqitur këtë projektligj!

Bëhet fjalë për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të konferencës së shteteve anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Certifikimit, si dhe Kontrollin e Detarëve në përgjithësi.

Termi “detarë” përfshin të gjithë personelin lundrues të çfarëdolloj flote, e cila, në një mënyrë apo në një tjetër, është e organizuar në nivel ndërkombëtar përmes kësaj konvente, e cila, për axhevolacionet që krijon, ka bërë që të aderojnë mbi 98% e mjeteve lundruese në nivel global. Kjo përqindje është rritur shumë edhe vitet e fundit. Ky nuk është një ligj që vendoset për herë të parë, sepse Shqipëria ka kohë që ka aderuar në këtë konventë, por bëhet fjalë për amendime të pikave të caktuara që kanë të bëjnë me kodet e konventës.

Për hir të së vërtetës kodi i konventës është shumë voluminoz, 250-300 faqe, sikurse shumica e kodeve që kanë të bëjnë me specifikime teknike, megjithatë ne e kemi edhe në format dhe mund t’ia nisim anëtarëve të komisionit që e duan. Kryesisht është me tabela dhe specifikime të natyrës së standardeve.

Gjithsesi, doja të thosha që ky projektligj synon të plotësojë kuadrin ligjor për kualifikimin, certifikimin, si dhe kontrollin e performancës së detarëve apo edhe të ekuipazheve të ndryshme, të cilët përditësohen.

Kjo konventë nuk është vetëm për ne, por po përditësohet në nivel global dhe ne po plotësojmë vetëm një detyrim. Kryesisht ndryshimet kanë të bëjnë me përditësimet në fushën e ndryshimeve klimaterike në botë, qëndrimin jetik të flotave të ndryshme, gjëra që kanë të

bëjnë, qoftë me shkarkesat në det të mbetjeve, qoftë me qëndrimet që mbahen ndaj vendeve të ndryshme.

Për sa i përket çështjes së sigurisë, për të cilën është i interesuar komisioni juaj, konventa zhduk pabarazitë midis vendeve që janë ose jo anëtare të konventës, pavarësisht se numri i vendeve që nuk janë pjesë e konventës është shumë i vogël. Dikur ka qenë me axhevolacion të lundroje me flamur të disa vendeve, të cilët krijojnë akses në porte të ndryshme, kurse sot kjo lloj lehtësie është zhdukur. Kështu që, asnjë vend nuk ka leverdi të qëndrojë jashtë konventës, sikurse ka qenë deri para disa viteve.

Pikat kryesore, pa dashur t'ju marr kohë, por duke qëndruar te thelbi, janë:

përmirësimi i masave për të parandaluar taktikat mashtruese që lidhen me dhënien e certifikatave të kompetencës;

rishikimi i kërkesave për orët e punës dhe të pushimit, si dhe kërkesat e reja për parandalimin e abuzimit me drogën dhe alkoolin, si dhe standardet e përditësuara. Për sa i përket orëve të punës, patëm një diskutim edhe në një komision tjetër para dy ditësh. Meqenëse detarët rrinë 24 orë në anije, ata kanë një formulë të tyre për të kalkuluar orët e punës me orët e qëndrimit në anije, që janë të dyja palët të paguara nga njëra anë, por jo me të njëjtën vlerë pagese.

Kërkesat e reja të certifikimit për detarët.

Kërkesat e reja në lidhje me trajnimin në teknologjinë moderne, siç janë tabelat elektronike dhe sistemet e informacionit (ECDIS).

Kërkesat e reja për trajnimin dhe paralajmërimin për ndotjen ndaj mjedisit detar dhe trajnimin e drejtuesve dhe punës në grup.

Kërkesa të reja të trajnimit dhe certifikimit për oficerët elektroteknikë.

Përditësimi i kërkesave të kompetencës për personelin që shërben në të gjitha llojet e cisternave, duke përfshirë kërkesat e reja për personelin që shërben në cisternat me gaz të lëngët, por në përgjithësi edhe cisternat që kanë lëndë shpërthyes.

Kërkesa të reja për trajnimin e sigurisë, si dhe dispozita për të siguruar se detarët janë të trajnuar siç duhet për të përballuar nëse anija e tyre bie pre e sulmit të piratëve. Kjo është një nga pjesët që azhurnohet vazhdimisht.

Futja e metodologjisë së trajnimit modern duke përfshirë mësimin në distancë dhe trajnimin në internet.

Udhëzime të reja trajnimi për personelin që vepron në sistemin pozicionues dinamik.

Këto kanë të bëjnë me gjeoreferencimet dhe sistemet e reja që bëjnë të mundur qoftë lokacionin e anijes, qoftë lokacionin e mjeteve të tjera lundruese apo edhe vendeve dhe pikave karakteristike të bregdetit në rastin e anijeveqë ndodhen në det të hapur.

Pa dashur të futem në shumë teknikalitete, doja të thosha që në një masë shumë të madhe sot ne operojmë sipas kësaj konvente. Azhurnimet janë deri diku kozmetike, sepse, ngaqë azhurnohen herë pas here, në rastin konkret nuk ka azhurnime për sa i përket punës që bën ky komision. Për pjesën e sigurisë ngelen të njëjtat pika dhe dispozita që kanë qenë, që, sikurse e theksova më sipër, kanë të bëjnë më tepër me trajnimin, kurse disa dispozita kanë të bëjnë me njohjen e disa parametrave që anijet duhet t'i kenë në raport me ndotjen globale: ulja e CO2-it, çështja e trajtimit të mbetjeve që kanë anijet dhe gjëra të tjera të kësaj natyre.

Duket sikur jemi me vonesë, sepse azhurnimet e fundit janë bërë në vitin 2010, por jo, sepse vende të ndryshme janë edhe më me vonesë se ne për azhurnimin e pikave të ndryshme, pasi këtu kemi të bëjmë me kode. Për fat të mirë asnjë nga pikat tona nuk prek Kodin Detar, sepse për prekjen e kodit duhet siguruar, normalisht, jo në kushtet që ndodhemi, një numër shumë i madh votash në parlament.

Pra, vende të ndryshme ndonjëherë i shtyjnë edhe me 5-6 vjet, me një ndryshim shumë të vogël, sepse nuk arrijnë ta ratifikojnë në parlament. Ne nuk e kemi këtë problem për momentin, pra nuk ka pika që prekin Kodin Detar, përveç azhurnimeve, që i përmenda më lart.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Shkreli!

Në fakt, Kodi Detar është një ligj i cilësuar, i cili është diskutuar edhe në Komisionin e Sigurisë. Si sot, ashtu edhe në kohën kur ne e kemi diskutuar këtë ligj, ky komision nuk ka qenë komision përgjegjës, por komision për dhënie mendimi.

Sigurisht, për të tërhequr edhe vëmendjen e gjithë kolegëve, është e rëndësishme pasja dijeni për këtë konventë dhe për instrumentin e aderimit të Republikës së Shqipërisë në këtë konventë, për faktin e thjeshtë se transporti detar mbetet një nga llojet më të rëndësishme të transporteve, ku besoj se (do të kemi edhe fjalën e relatorit) transporti kargo mbetet shumë i rëndësishëm, sepse është pothuajse mënyra e vetme si realizohet transporti i gjërave, që janë edhe në sasi, edhe në peshë të madhe. Ka shumë rendësi që gjithë ky transport të zhvillohet në një mjedis të sigurt, por, nga ana tjetër, të zhvillohet në mënyrë të tillë që të ruajë edhe parametrat e mjedisit, që ju i përmendët në fjalën tuaj.

Sidoqoftë, për të na folur diçka më tepër, do të doja t'ia kaloja fjalën relatorit, zotit Vorpsi. Më pas kolegët, nëse kanë pyetje për relatorin ose përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës, janë të lutur t'i bëjnë.

Faleminderit!

Sadi Vorpsi - Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në radhë të parë do të doja të falënderoja zëvendësministrin Shkreli për parashtrimin e këtij projektligji në detaje! Prandaj edhe unë dua të flas shkurtimisht si relator i këtij projektligji shumë të rëndësishëm për Republikën e Shqipërisë.

Projektligji synon të plotësojë kuadrin ligjor në fushën e kualifikimit dhe testimit për shërbimet detare, duke përcaktuar standardet minimale në lidhje me trajnimin, certifikimin dhe mbajtjen e vëzhgimit për detarët, në vende që janë të detyruara t'i përmbushin ose t'i tejkalojnë këto standarde.

Objekti i këtij projektligji është miratimi edhe nga Republika e Shqipërisë, si shtet anëtar i IMO-s, i ndryshimeve të konventës, i cili do të ndikojë ndjeshëm në përmirësimin e standardeve kombëtare të nevojshme për institucionet e trajnimit dhe trajnuesit për të zhvilluar aftësitë dhe kompetencat kaq shumë të nevojshme për marinarët e sotëm, duke u bazuar në standarde.

Gjithashtu, projektligji ka edhe disa objektiva të tjera, si përmirësimi i masave për të parandaluar praktikat mashtruese, që lidhen me dhënien e certifikatave dhe kompetencës dhe për të forcuar procesin e vlerësimit; rishikimi i kërkesave për orët e punës dhe pushimit, kërkesat e reja për parandalimin e abuzimit me drogën dhe alkoolin, si dhe standardet e përditësuara në lidhje me standardet e përshtatshmërisë mjekësore për detarët; kërkesa të reja të certifikimit për detarët, të trajnimit dhe certifikimit për oficerët elektro-teknikë; kërkesa në lidhje me trajnimin në teknologjitë moderne, siç janë tabelat elektronike dhe sistemet e informacionit; kërkesat për trajnimin e parandalimit për ndotje ndaj mjedisit detar e trajnimin e drejtuesve të punës në grup për trajnimin e sigurisë, si dhe dispozitat për të siguruar se detarët janë trajnuar siç duhet për ta përballuar nëse anija e tyre bie në sulmin e piratëve; përditësimi i kërkesave për personelin që shërben në të gjitha llojet e cisternave, duke përfshirë kërkesat e reja për personelin që shërben në cisternat me gaz të lëngët; futja e metodologjisë së trajnimit modern, duke përfshirë mësimin në distancë dhe trajnimin në internet; uzina të reja trajnimi për personelin që vepron në sistemin e pozicionimit dinamik.

Nisur nga rëndësia e këtij projektligji, do t'i ftoja të gjithë kolegët deputetë që të gjithë se bashku ta miratojmë këtë projektligj kaq të rëndësishëm për Republikën e Shqipërisë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Vorpsi!

Fjala është për kolegët, nëse kanë ndonjë pyetje.

Po bëj unë një pyetje. Kjo konventë dhe fakti që ne aderojmë në të e bën të detyrueshme për anijet e peshkimit përdorimin e sistemit *bluebox*? Kjo ishte pyetja ime e parë.

Pyetja e dytë është: a hyjnë në fushën e veprimit të kësaj konvente anijet luftarake?

Faleminderit!

Artan Shkreli – Për t’u përgjigjur, as njëra kategori, as kategoria tjetër nuk janë objekt i kësaj konvente. Konventa është për mjetet lundruese, të cilat kryejnë aktivitet tregtar dhe shkëmbim mallrash. Pra, flotat luftarake nga njëra anë dhe anijet e peshkimit nga ana tjetër, për sa kohë nuk merren me aktivitet tregtar, nuk bëhen pjesë e kësaj konvente. Flotat luftarake e kanë absolutisht të ndaluar. Ka edhe disa ndërmarrje, po themi, hibride, të cilat edhe peshkojnë, edhe tregtojnë. Në momentin kur ata merren me tregti, bëhen pjesë e kësaj (flas për anijet e peshkimit), kur janë thjesht anije peshkimi, që do të thotë se stokun e peshkut, e thënë me fjalë të varfra, duhet ta magazinonjë, ta doganojnë e të tjera në tokë paraprakisht, atëherë kjo nuk është pjesë... Ato rregullohen nga ligje të veçanta.

Këtu edhe depozitat, po themi, për mbrojtjen e një sulmi piratesk, kanë të bëjnë më tepër me faktin që shumica e këtyre anijeve janë të siguruara. Ata nuk duhet të reagojnë në mënyrë të dhunshme ndaj piratëve e të tjerë. Nuk lejohen, në njëfarë mënyre, se gjestet e heroizmit në këtë pikë...

Ermonela Felaj – Ka kufizime në mënyrën si veprojnë.

Artan Shkreli - Madje, shoqëritë e sigurimeve, në momentin kur krijohet një dëm, që ka ardhur si reaksion i rezistencës së anijeve, nuk marrin parasysh as dëmet pastaj, se thonë që ju duhet ta dorëzonit anijen siç është e të tjerë. Këto janë pjesë e trajnimit.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjala është për zotin Harusha.

Luan Harusha – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit për prezantimin e këtij projektligji!

Kisha një pyetje: të gjitha rezolutat i lexova, pak a shumë, por nuk e kuptoj, te rezoluta nr.18, çfarë do të thotë viti i detarëve?

Faleminderit!

Artan Shkreli – Kjo është një gjë e re. Nuk ka ndonjë rëndësi shumë të madhe në kuptimin teknik. Sikurse ka ditë të nënës, ditë të librit, është vendosur nga konventa ndërkombëtare të ketë edhe një ditë të detarëve. Ka pasur shumë kërkesa edhe nga vende të ndryshme, sidomos nga vende që kanë ushtruar gjatë detarinë. Nja dy vende, mesa di unë, e kanë edhe ditë nacionale, vende që e kanë mbështetur ekonominë te deti. Kështu që kanë caktuar një ditë që është dita e detarëve. Viti i detarëve më duket se ka qenë përpara 10 vjetësh.

Pra, një herë në kaq kohë konventa përcakton se cili është viti i detarëve dhe atë vit bëhen aktivitete të ndryshme për detarët dhe detin në të gjithë vendin. Për paralelizëm jo shumë të afërt, por që të jep idenë e tillë, po them, për shembull, viti i Skënderbeut që u bë në Shqipëri me rastin e 650-vjetorit. Pra, nga konventa caktohet një vit, ku organizohen aktivitete për detin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më tha kolegu, që në vitin e fundit detar si tematikë ka qenë promovimi i grave në fushën e detarisë, meqenëse ka pasur pak pjesëmarrje të grave në detari. Pra, më tepër janë promovuese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjatë atij viti zhvillohen aktivitete të ndryshme. Normalisht, nëse viti i detarëve ose i detit do të jetë në vitin 2020, republika jonë që aderon në atë konventë duhet të zhvillojë aktivitete të herëpashershme gjatë atij viti, për shembull, në rastin konkret promovimin e aderimit të grave në fushën e lundrimit apo hapjen e kurseve në shkolla të ndryshme për fëmijët, ku njihen me botën e detit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, çdo vend duhet të vendosë buxhetin e vet.

Ermonela Felaj – Po i bashkohem pak pyetjes suaj, cili do të jetë institucioni që do të ketë për detyrë zbatimin e këtij projektligji apo të konventës, sepse projektligji na ngarkon detyrimin për ta zbatuar?

Artan Shkreli – Në rastin e vendit tonë duhet ta ketë Ministria e Infrastrukturës dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare. Në vende të caktuara nganjëherë aderojnë edhe ministrinë që mbulojnë fushën e transportit dhe tregtisë.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera nga kolegët? Unë kam edhe një sugjerim të fundit përpara se të kalojmë në miratimin e këtij projektligji. Pak më herët ne kemi diskutuar edhe për aderimin në konventën “Për falsifikimin e monedhave”. Kjo konventë është e vitit 1929, por detyrimet për përmbushjen e kapitullit që lidhet me sigurinë dhe me faktin që ne aspirojmë për t’u bërë pjesë e Bashkimit Europian, na e bënë të detyrueshme edhe aderimin në këtë konventë. Por gjëja që dua të ndaj me ju është kjo: patëm një diskutim në komision nëse termi i duhur do të ishte “aderim” apo “ratifikim” dhe shpjegimi që na u dha, unë besoj se ky shpjegim duhet të merret nga Ministria e Jashtme, sepse ajo ka ekspertët përkatës, ishte që më i përshtatshëm ishte termi “aderim” dhe jo “ratifikim”. Për këtë arsye seanca për miratimin e asaj konvente u shty për një seancë tjetër dhe në fund u vendos termi “ratifikim”.

Unë nuk e kam përshtypje, por jam e bindur edhe nga verifikimi që kam bërë në faqen e Këshillit të Europës që duhet termi “aderim” dhe jo “ratifikim”. Pra, ashtu siç ju e keni sjellë në propozimin tuaj, sepse është një tjetër mënyrë që u jep mundësi shteteve që të marrin pjesë në një traktat ndërkombëtar, në nënshkrimin e të cilit nuk kanë marrë pjesë. Pra, i njëjtë është rasti edhe për konventën tjetër. Prandaj insistoј që në rast se do të keni një diskutim në një komision tjetër parlamentar për këtë çështje, ju lutem, përdoreni këtë gjë që është zyrtare dhe të mos u lëmë rrugë qëndrimeve individuale, të cilat, për fat të keq, vijnë edhe nga njerëz që nuk kanë eksperiencë në të drejtën ndërkombëtare. Kjo duket sikur është një gjë e vogël, por në fakt titulli shpreh përgjegjësinë që ne kemi apo ekzekutivi ka në propozim dhe pastaj në miratimin e akteve të ndryshme ligjore.

Kalojmë në miratimin e projektligjit. Kush është dakord me miratimin në parim të projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të Konferencës së shteteve anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët”?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në miratimin nen për nen. Kush është dakord me nenin 1 të projektligjit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Në nenin 2 parashikohet që ligji të hyjë në fuqi në afatin e zakonshëm. Kush është dakord me këtë parashikim?

Miratohet.

Kush është dakord për miratimin e projektligjit që siguron aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Ky projektligj miratohet.

Përfaqësuesve të ministrisë u uroj punë të mbarë!

Kolegë, mbledhja tjetër është nesër në orën 10:30 dhe ka për rend dite shqyrtimin e ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale. Relatore për këtë projekt do të jetë zonja Elena Xhina.

Mbledhja mbyllet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA